

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” ka për qëllim rikonceptimin dhe riorganizimin e sistemit të titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë, qoftë të atyre që jepen nga kryetari i shtetit, qoftë të titujve vendorë që jepen nga organet e vetëqeverisjes vendore (Këshilli Bashkiak). Titujt e nderit jepen në mbështetje të parimeve të nderimit publik dhe të vlerësimit të kontributit, ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj, që janë dalluar në kryerjen e veprimtarive të fushave të ndryshme, brenda ose jashtë vendit, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të shtetit, kombit shqiptar apo komunitetit të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Tipari parësor i riorganizimit sipas kësaj nisme është ndarja dhe dallimi i “titujve të nderit” nga “dekoratat”, të cilat janë propozuar të rregullohen nëpërmjet një projektligji tjetër, që i është propozuar Kuvendit për shqyrtim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 483, datë 21.7.2022. Pra, qasja e re normative që synohet nga Këshilli i Ministrave është ajo e trajtimit më vete të titujve të nderit, nga dekoratat, ndryshe nga korniza ligjore aktuale e cila i rregullon bashkërisht të dy kategoritë (ligji nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”).

Kjo nismë diferencuese ndërmerret duke mbajtur në konsideratë rregullimet ligjore të kësaj fushe të vendeve evropiane, kryesisht modelin italian dhe francez. Vlen të theksohet këtu se, duke u mbështetur në këto modele, sistemimi i ri i rikthehet edhe traditës shtetërore shqiptare të kësaj fushe të periudhës 1914-1944, që ka qenë një nga qëllimet thelbësore të tij.

Përpos sa më sipër, qëllimet e nismës kanë të bëjnë edhe me ripërcaktimin e rregullave dhe të procedurës përkatëse për dhënien e titujve të nderit.

Në sintezë të sa më sipër, objektivi i projektligjit lidhet me rimodelimin e sistemit të titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë dhe konsolidimin e legjislacionit përkatës, duke i shërbyer sa koherencës, aq edhe rievokimit të traditës ligjore të mëparshme.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në programin analitik të përgjithshëm të projektakteve të miratuar me vendimin nr. 850, datë 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë 2022”. Projektakti nuk është i parashikuar në programin politik të Këshillit të Ministrave. Ajo çfarë mund të përmendim është se ai (projektakti) i përgjigjet vizionit të Këshillit të Ministrave për një sistem serioz dhe të konsoliduar të dhënies së titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji në fjalë ka si objekt përcaktimin e llojeve të titujve të nderit dhe titujve vendorë që jepen në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullave, procedurave dhe kritereve për propozimin, shqyrtimin dhe dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse.

Sikurse është parashtruar edhe më sipër, projektligji paraqet risi që lidhen me çështjet e llojeve të titujve të nderit, autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre si dhe procedura që ndiqet për këtë, në raport me ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 112/2013).

Konkretisht, ligji nr. 112/2013 nuk ka pasur të përcaktuar në mënyrë të qartë subjektet të cilëve u jepen dekoratave sipas kushteve dhe kritereve ligjore, duke përmendur vetëm termat “personalitete shqiptare” apo personalitete të huaja”. Në projektligj janë përcaktuar subjektet përfitues, të cilët mund të jenë shtetasit shqiptarë ose të huaj që janë dalluar në kryerjen e veprimtarive të fushave të ndryshme, brenda ose jashtë vendit, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të shtetit, kombit shqiptar apo komunitetit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Sa i takon llojeve të titujve të nderit, projektligji parashikon 2 lloje të titujve të nderit në nivel kombëtar, ndryshe nga ai ekzistues i cili konfondon ato që tradicionalisht kategorizohen si dekorata – urdhra dhe medalje, me titujt e nderit. Pra, për shkak të këtij konfuzioni dhe kategorizimi të ligjit aktual, është krijuar një tablo e pasaktë dhe e tejzgjeruar e titujve kombëtarë të nderit. Përkundrajt kësaj situatë, titujt kombëtarë që parashikon projektligji janë “Titulli Ambasador i kombit” dhe “Titulli Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë”. Ky i fundit aktualisht, sipas ligjit në fuqi, trajtohet si medalje që jepet nga Kuvendi dhe jo si titull nderi. Për sa u përket titujve vendorë të nderit, projektligji parashikon titullin

“Qytetar nderi” dhe, përveç tij, u jep mundësinë njësive të vetëqeverisjes vendore që me akt (vendim) të tyre të krijojnë tituj të vecantë vendorë duke argumentuar nevojën specifike për to, si dhe duke plotësuar kriteret e tjera të parashikuara në projektligj.

Më tej, projektligji qartëson ndarjen dhe diferencimin e secilit prej titujve të nderit, sipas specifikave përkatëse, duke përcaktuar qartësisht kriteret që duhet të përmbushen nga subjektet për përfitim të tyre, dhe rregullat për dhënien e tyre, në dallim nga ligji nr. 112/2013.

Sa i takon autoriteteve përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit në nivel kombëtar, projektligji rikonfirmon kompetencën e Presidentit të Republikës për akordimin e tyre.

Ligji nr. 112/2013, ka qenë jo i plotë në drejtim të rregullimit të rasteve kur u hiqet titulli i nderit subjekteve që e kanë marrë atë sipas ligjit. Në projektligjin e ri janë përcaktuar këto raste në mënyrë shteruese, të cilat përmbajnë rrethana të atilla që e bëjnë të pamundur objektivisht mbajtjen e titullit të nderit.

Për sa i përket aspekteve procedurale, projektligji bën një rregullim më të hollësishëm të çështjeve që lidhen me nismën për dhënien e titujve të nderit, propozimin e tyre, kërkesën e qytetarëve për ushtrimin e nismës/propozimit për dhënien e titullit për të tretë, ngritjen dhe funksionimin e komisioneve këshillimore për shqyrtimin e këtyre nismave/propozimeve. Në këtë kontekst, gjejmë rastin të përmendim se parashikimi i mundësisë së qytetarëve për të kërkuar ushtrimin e nismës/propozimit për dhënien e titullit të nderit një të treti (personi tjetër), është një risi në raport me ligjin nr. 112/2013. Gjithashtu, ndryshe nga ligji në fuqi, ky projektligj parashikon se dhënia e titullit të nderit apo titullit vendor të nderit nuk shoqërohet me shpërblim financiar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet nga Këshilli i Ministrave për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Nga pikëpamja thelbësore-lëndore ai është në përputhje me nparimet dhe normat kushtetuese. Projektligji respekton parashikimet e nenit 92, shkronja “ç” të Kushtetutës, lidhur me kompetencën e Presidentit të Republikës për dhënien e titujve të nderit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së, ndaj nuk ka vend për vlerësim të shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Normat e parashikuara në projektligj janë materializuar në 22 (njëzet e dy) nene, të strukturuar në pesë krerë, për të cilat parashtrajmë në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e tyre si më poshtë.

Kreu I (nenet 1-4), përmbajnë dispozitat e përgjithshme të këtij projektligji, që lidhen me objektin, qëllimin e projektligjit, parimet e përgjithshme mbi bazën e të cilave ushtrohet funksioni i dhënies së titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë, si dhe me cilësimin e subjekteve përfitues të tyre.

Kreu II (nenet 5-7) përmban parashikime për titujt e nderit 9 në nivel kombëtar), duke cilësuar konkretisht dy llojet e tyre:

Titulli Ambasador i kombit, i cili i jepet shtetasve shqiptarë ose pjesëtarëve të diasporës, në shenjë mirënjohje për veprimtari, kontribute dhe merita të spikatura e të qëndrueshme, që lartësojnë vlerën dhe figurën e kombit shqiptar; si dhe

Titulli Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë, i cili i jepet shtetasve të huaj në shenjë mirënjohje për veprimtari, kontribute dhe merita të spikatura në shërbim të kombit e shtetit shqiptar dhe të forcimit të shoqërisë demokratike, brenda dhe jashtë vendit.

Kreu III (nenet 8-10) shtjellon titujt vendorë të nderit, duke përcaktuar si titullin tipik të kësaj kategorie titullin "Qytetar nderi", i cili jepet nga këshilli bashkiak për veprimtari të shquar brenda juridiksionit dhe në dobi të bashkisë ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit të bashkisë. Ky titull nderi i jepet në çdo rast edhe personaliteteve të huaja të nivelit të lartë që vizitojnë një bashki në kuadër të një vizite zyrtare ose shtetërore.

Krahas tij, projektligji parashikon mundësinë e Bashkive për të krijuar tituj të veçantë vendorë nderi (jo më shumë se dy në një vit kalendarik), për të shprehur mirënjohjen e posaçme për veprimtarinë e shquar në dobi të komunitetit të saj. Në të njëjtën linjë, me qëllimin për të moslejuar krijimin dhe dhënien në mënyrë të pajustificuar të këtyre titujve, parashikohet se në vendimin e krijimit të tyre, NJ.V.V. duhet të përcaktojë:

- a) nevojën për nderimin e veçantë;

b) arsyen përse nderimi me titullin qytetar nderi, nuk është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm dhe shtetasi i propozuar për nderim duhet dalluar nga shtetasi tjerë; dhe

c) emërtesën e titullit të veçantë vendor të nderit i cili përkon me një datë ose ngjarje të shënuar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kreu IV (nenet 11-19) përmban rregulla mbi procedurën e nderimit (dhënies së titujve të nderit, duke përfshirë ata vendorë).

Së pari dispozitat e këtij kreu ndalen tek e drejta për të ushtruar nismën për nderim, ose për të propozuar nderimin. Kështu, për titujt kombëtarë nisma i përket Presidentit të Republikës, i cili e ushtron kryesisht, ose me propozim të Kryetarit të Kuvendit, ose Kryeministrit. Ndërsa në rastin e titujve vendorë e drejta e propozimit i përket kryetarit të bashkisë, si dhe cdo anëtar i të këshillit bashkiak. Më tej, normohet “Kërkesa për ushtrimin e nismës ose propozimit” që mund të paraqitet nga qytetarët drejtuar institucioneve nismetare/propozuese të nderimit, në favor të një të treti. Kjo, sikurse e përmendëm edhe në krerët pararendës të këtij relacioni, përbën një parashikim të ri procedural të projektligjit, i cili nuk është i rregulluar aktualisht në kuadrin në fuqi.

Në vijim, dispozitat e kreu rregullojnë të drejtën e propozimit duke përcaktuar se cdo propozim formal duhet të përmbajë këto elemente:

- a) institucionin propozues;
- b) bazën ligjore për propozimin,
- c) të dhëna identifikuese të shtetasi të propozuar për nderim;
- ç) lidhjen midis institucionit dhe shtetasi të propozuar për nderim;
- d) veprimtarinë e kryer nga shtetasi i propozuar për nderim, si dhe arsyet e hollësishme për nderimin e tij;
- dh) llojin e titullit të propozuar;
- e) informacione, shoqëruar me dokumentacionin provues, që vërtetojnë përmbushjen e kritereve përkatëse për nderim, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- ë) informacioni se shtetasi i propozuar për nderim nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, si dhe që nuk është nën hetim ose gjykim për një veprë penale nga organet përgjegjëse;
- f) të dhënat për dekorime ose nderime të mëparshme të shtetasi të propozuar;
- g) cdo element tjetër të nevojshëm për verifikimin dhe plotësimin e kritereve përkatëse për nderim.

Më tej, ky kre ndalet tek ngritja e komisioneve këshillimore *ad hoc*, pranë organeve kompetente vendimmarrëse (përkatësisht Presidenti, ose nj.v.v.) për

shqyrtimin e nismave dhe propozimeve për nderim. Në këtë kuadër, sqarohet gjithashtu procedura e shqyrtimit paraprak të propozimit, që ka të bëjë me verifikimin e aspekteve formale të propozimit dhe më pas procedura e shqyrtimit të mirëfilltë (substancial) të tij. Në përfundim të këtij shqyrtimi komisioni i dërgon autoritetit përgjegjës për dhënien e titullit mendimin e tij për:

a) miratimin e nismën ose propozimit;

b) refuzimin e nismës ose propozimit për shkak të mosplotësimit të të metave brenda afatit 10 (dhjetë) ditor ose për shkak të mos përmbushjes së kriterëve sipas këtij ligji.

Akti përmes të cilit vendoset përfundimisht miratimi ose refuzimi i propozimit është dekreti në rastin e titujve të nderit kombëtarë, ose vendimi në rastin e titujve vendorë të nderit.

Dispozita e fundit e këtij kreu rregullon “heqjen e titujve të nderit(përfshirë ata vendorë)”, e cila bëhet:

a) me vendim të formës së prerë të dhënë nga gjykatat shqiptare, kur është dhënë si dënim plotësues sipas përcaktimeve në Kodin Penal;

b) me vendim të institucionit përgjegjës për dhënien e titullit ose titullit vendor të nderit, kur mbajtësi i tij:

i) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, ose

ii) është shpallur “person i padëshiruar”, sipas përcaktimeve të legjislacionit që rregullon regjimin e hyrjes e të qëndrimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë.

Së fundmi, Kreu V (nenet 20-22) është ai i dispozitave kalimtare dhe të fundit të projektligjit. Këtu parashikohet detyrimi i Këshillit të Ministrave për të nxjerrë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit aktin nënligjor në zbatim të nenit 14 pika 4, të tij (Rregullat e hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin, si dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të komisioneve këshillimore). Gjithashtu kreu përmban një dispozitë kalimtare që përcakton se: *“Të gjitha titujt të dhënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihen dhe mbahen sipas motivacionit dhe kushteve me të cilat janë dhënë. Heqja e tyre bëhet sipas përcaktimeve të këtij ligji.”*

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë :

a) Presidenti i Republikës dhe Këshillat bashkiake, në cilësinë e autoriteteve përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit.

- b) Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetarët e bashkive dhe cdo anëtar i këshillave bashkiake, në cilësinë e autoriteteve që kanë të drejtën e propozimit për nderim;
- c) Këshilli i Ministrave i cili ngarkohet për nxjerrjen e aktit nëligjor “Për rregullat e hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin, si dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të komisioneve këshillimore”.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 97, datë 10.6.2022 “Për ngritjen e grupit të ekspertëve për përgatitjen dhe hartimin e dispozitave ndryshuese të akteve ligjore e nënligjore për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji i është përcjellë për mendim Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Kulturës, Ministrit të Brendshëm, Këshillit Konsultativ Qeverisje Qendrore-Qeverisje vendore, Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikohet të sjellë rritje të shpenzimeve buxhetore pasi nuk përcakton detyra të reja të institucioneve zbatuese (dhënia e titujve të nderit është veprimtari ekzistuese) dhe as nuk sjell krijimin e institucionave, organeve, apo strukturave të reja.

Në të kundërt projektligji, mund të sjellë ulje të shpenzimeve si pasojë e faktit se në projektligj (neni 3, pika 3), ndryshe nga legjislacioni aktual, parashikohet se dhënia e titujve të nderit nuk do të shoqërohet më me shpërblim financiar.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA